REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 322-323-326/20
Data/Datum 11.06.20

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**01.06.2020**	**11.06.2020**	**Nr.322/20, Nr.323/20 Nr.326/20**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë: 22.05.2020 OE "**IPE CONTROLS- ING**" ka parashtruar ankesën me nr:322/20 për Lot 1 dhe me datë 26.05.2020 kanë parashtruar ankesat OE **"IPE PROING"** me nr.323/20 për Lot 1 dhe Lot 2 si dhe OE **"ETL KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000"** me nr.326/20 për Lot 1 dhe Lot 2, kundër vendimit për **dhënie** të aktivitetit të prokurimit **"Ekzaminimet kontrolluese per materiale dhe kualitetin e punëve, ne projektet e infrastrukturës rrugore" Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prok.205/19/1724/211**, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Ministria e Infrastrukturës.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **1.500.000,00 €.**

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr. 459-460/19, Nr. 815-818-825-832/19 dhe Nr.84-101/20

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "IPE CONTROLS- ING"

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim jo diskriminimi
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret e dhënies së kontratës
- Neni 64 i LPP-së – Dëshmia e kërkesave
- Neni 68 i LPP-së – Gjendja ekonomike financiare
- Neni 69 i LPP-së – Aftësia teknike dhe/ose profesionale
- Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Vendimi i OSHP-së nr.459-460/20 i datës 11.09.2019

Nr.815/19, Nr.825/19
Nr.818/19, Nr.832/19

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Te nderuar, ne me dale: 07.05.2020 ne platformën elektronike tc prokurimit kemi pranuar njoftimin rnbi vendimin e AK-se, ku ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa është rekomanduar për kontrate OF: "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K për Lot 2.

Fillimisht ju rikujtojmë se po vazhdojmë të diskriminohemi nga ana e AK-se pasi që është rekomanduar për kontratë OE i cili është i pa përgjegjshëm për arsyet si në vijim:
OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te parashikuara tek neni 9.1 & 9.2.3 i FTD-se, pasi qe ne listën c prezantuar te stafit për këtë projekt, OE i rekomanduar për kontratë ka caktuar për laborant teknik për Lot 1 dhe 2 z. Burirn Binaku i cili ka te kryer vetëm shkollën e mesme teknik i xehetarisë, ndërsa kërkesë ka qene teknik i ndërtimtarisë.
Ne lidhje me këtë pretendim ju sqarojmë se ekziston vendimi i OSHP-se, Nr.459,460-19 i dLII.09.2019, ku është konstatuar se OE [ani i rekomanduar për kontrate IMK Ballkan është i papërgjegjshëm me arsyetimin se për laborant teknik ka prezantuar z.Burim Binaku
i cili është me shkolle te mesme te xehetarisë pra teknik i xehetarisë, e jo teknik i ndërtimtarisë ashtu siç është kërkuar ne dosje Ie tenderit sipas sqarimeve te dales:03.04.20 19 dhe 26.04.2019. Duke pasur parasysh kete fakt rezulton se OE M K Ballkan është i papërgjegjshëm dhe tanimë ky pretendim është çështje e gjykuar-Rcs Judicata dhe se ky operator ekonomik nuk mund te shpallet fitues ne asnje mënyrë me këto dëshmi, e te cilat janë vërtetuar nga nje organ administrativ i shkalles me te larte.
Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate me vendim ka caktuar z. Shabi Binaku laborant per Lot 2, i cili është teknik i xehetarisë edhe pse është kërkuar teknik i ndërtimtarisë, prandaj OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm sipas nenit 59.4 Ie LPP-se, sepse për tu konsideruar një OE i përgjegjshëm duhet ti plotësojë te gjitha kërkesat c FTD-se dhe te njoftimit për kontrate.

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nc nenin 9.1 &9.2 Ie FTD-se është kërkuar ndn 3. Inxhinier i diplomuar i teknologjisë se materialeve tc ndërtimit/ inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, ndërsa OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar z. Afrim Qela i cili ka kualifikim inxhinier i teknologjisë ushqimore dhe është i diplomuar ue Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë ne Mitrovice. Prandaj edhe kete kërkesë recidive te FTD- sc nuk e ka plotësuar OE i rekomanduar për kontrate.

Gjithashtu ne dosje te tenderit tek kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar', neni 8.1&8.2, është kërkuar Deklaratat Tatimore vjetore tc dorëzuara ne A TK per tri vitet e fundit, ndërsa OE i rekomanduar per kontrata ka ofruar deklaratat tatimore vjetore te pa vulosura dhe te pa nënshkruara nga ATK-ja, andaj ne dyshojmë se këto deklarata janë te manipuluara dhe se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson as këtë kërkesë.
Kërkojmë qe te vërtetohet ky pretendim i yni ne lidhje me deklaratat e tatimore vjetore sepse është e pamundur i njëjti operator ekonomik te këtë secilin vit qarkullim te përafërm nga 300 mije euro me këto punc dhe shërbime te ne si kompani i kryejmë. Prandaj nc dyshojmë se këto deklarata nuk janë te sakta dhe kërkojmë verifikimin e lyre, pasi qe këto deklarata qe nxjerrën nga ATK-ja ne menyre elektronike shume lehte mund re ndryshohen dhe te përmirësohen.

Dyshimin tone për manipulim te këtyre deklaratave e bene edhe me te forte edhe fakti qe dëshminë e qarkullimit bankar te OE te rekomanduar për kontratë kane mospërputhje me deklaratat tatimore vjetore, prandaj vërtetimi i këtij pretendimi do te qartësonte gjithçka ne lidhje me këto dëshmi.
Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate çmimin e ofruar sipas procesverbal it te hapjes e ka tc njejte si pa TVSH si me TVSH, ndërsa operatorët ekonomik janë te detyruar te vendosin fillimisht çmimin pa TVSH ndërsa pastaj tc kalkulohet çmimi me TYSH. 1 vetmi OF. i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmimin e njëjtë si pa TVSH po ashtu edhe me TVSII, prandaj OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm dhe dyshojmë ne manipulime te çmimeve.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhc dëshmitë te cilat u përmenden me larte shihet qartë se OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm dhe gjithashtu shihet qartë se ne si OE i përgjegjshëm jemi duke u diskriminuar ne kete aktivitet te prokurimit, ku nuk po rekomandohemi për kontrate edhe pse i plotësojmë te gjitha kërkesat e FDT-se dhc te njoftimit pre kontrate ndërsa po rekomandohet per kontrate OE i cili është i papërgjegjshëm sic e cekem me larte per shkak se i njëjti OE nuk i ka plotësuar kërkesat ne lidhje me nenin 68 dhe 69 Ie LPP-se, prandaj autoriteti kontraktues po vepron nc kundërshtim me nenin 7 te LPP-sc gjate rivlerësimit te këtij aktivitcti te prokurimit.

Ne me dt.13.05.2020 kemi marre përgjigje ne kërkesën per rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore.
Ju sqarojmë sc AK-ja ka theksuar se deklaratat tatimore te OE te rekomanduar për kontrate kane barkod te ndryshëm per secilin vii, mirëpo nuk e ka marre per baze pretendimin tone se deklaratat e paraqitura nga OE i rekomanduar per kontrate jane te pavulosura dhe tc panënshkruara andaj dyshimi ynë per manipulim e deklaratave është ky, sepse edhe ne e dimë se deklarata tatimore kane barked te ndryshëm ne secilin vit, mirëpo ate duhet te janë te nënshkruara dhe te vulosura, andaj me këtë arsyetim te Ak-se, vetëm sa po shtohet dyshimet tona për manipulimin e këtyre deklaratave.

Gjithashtu AK-ja e ka cekur se pretendimet tona ne lidhje me stafin profesional nuk qëndrojnë, par nuk ka dhëne asnjë sqarim ne lidhje me stafin qe tregon se OE i rekomanduar për kontrate i plotëson kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate, pra nese OE i rekomanduar per kontratë i plotëson kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate AK-ja është dashur te sqaroj se si i plotëson këto kërkesa.
Po ashtu A K-ja nuk e ka sqaruar dhe nuk e ka marre per baze fare pretendimin tone ankimor ne lidhje 111C TVSH-ne, gjeq e tregon sc edhe AK-ja po e vërteton sc ky pretendim i yni qëndron dhe se OE i rekomanduar pre kontrate është i papërgjegjshëm.
Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me larte rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se dhc njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor per dhënie te kontratës, e qe ka qene tender i pa përgjegjshëm me çmim me tc ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-se.
Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk c ka pasur ne konsiderate edhe nenin I te LPP-sc, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është qe siguroje mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe Ie gjitha fundeve dhe burimeve te tera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.
Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhc dyshimtë qe u ceken me larte, kërkojmë nga OSHP-ja qe te mere

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "IPE CONTROLS - ING" SH ..P ..K, per lot 2
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-sc për dhënie te kontratës dhe lënda kthehet ne RIVLF.RESIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat c dosjes se tenderit, njoftimit për kontrate dhe konform dispozitave te LPP-sc.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën Ligjore ne institucionet tjera kompetente.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE **"IPE-PROING"**

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 61 i LPP-së – Tenderët jo normalisht të ulët

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht te Ulet

Ne baze te vendimit te publikuar mbi refuzimin e ankesës tone, me date 13.05.2020, ne sistemin elektronik e-prokurimi, Autoriteti Kontraktues pretendon se: ne si OE nuk kemi ofruar sqarime-përgjigje lidhur me kërkesën me shkrim për cmirnin jo-normalisht te ulet. Ky pretendim nga AK nuk qëndron, apo nuk është i bazuar. Për arsye se :

Që nga fillimi i kësaj] procedure tenderuese ne si OE kemi respektuar te gjitha procedurat qe kane te bëjnë me procesin e aplikimit ashtu siç janë kërkuar ne DT. Ne si OE kemi aplikuar me user me NUI 810841644. Po ashtu shpallja e ofertave nga AK na është bere ne këtë username ne platformën elektronike. Pas shpalljes se ofertave doli qe oferta jone ishte me cmimin me te ulet ashtu sig kërkohej ne DT. Pas kesa] AK na drejtohet me leter standarde ne emailinproing@msn.com duke kerkuar informata dhe shpjegime shtese pasi qe sipas tyre oferta jone cilësohej] si ofertë me cmim jo normalisht te ulet, Ne si OE i jemi përgjigjur përmes letrës standarde te datës 02.07.2019 AK (SOARIMI I <;MIMEVE) duke i ofruar shpjegime ne detaje ne lidhje me çmimet e ofertës tone duke ofruar edhe dëshmi se me këto çmime kemi operuar edhe me operator te tjerë ekonomik. Pas kësaj] AK na dërgon letër për eliminim dhe shpall fitues te njëjtit OE. Si rezultat i kësaj] lënda shkon ne OSHP ku ju si panel vendosni ne favor te ankesës sonë duke dërguar lenden ne rivlerësim. Pas kësaj] AK merr vendim per rivlerësim duke dal ne terren me konkretisht ne laborator per te verifikuar pajisjet e prezantuara ne DT. Pas verifikimit AK dërgon letër standarde ne usemame e vjetër. Të njëjtin veprim AK e persent edhe me vendimin e fundit te datës 13.05.2020 përmes te citit ne si OE kuptojnë qe letra standarde për crnimin jo normalisht te ulet është dërguar ne userin e vjetër dhe jo ne ate me te citin kemi aplikuar ne kete procedure tenderuese.

Është e pa kuptim qe ne si OE nuk do te përgjigjeshim ne ate letër standarde e aq me tepër kur çështja ka te beje me crnirnin jo normalisht te ulet per te citen çeshite ne si OE kemi ofruar shpjegime ne detaje me ane te letres standarde te dates 02.07.2019. Fakti qe i jemi përgjigjur AK-se lidhur me crnlrnin jo normalisht te ulet dëshmohet edhe ne raportin e juaj si OSHP te dates 11.09.2019 ku mes tjerash eksperti i angazhuar nga ana juaj thote: "OE ankues eshte përgjigjur per informatën lidhur me cmim: jo normalisht te ulet me daten 02.07.2019 dhe ne kuadër te kësaj përgjigje ka dhënë mjafte sqarime detale duke prezantuar kontratat e realizuar me cmime te ofertave me kete otette me te cilat ka operuar me klient te ndryshëm ne treg.

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi i LPP-se

Duke u bazuar ne vendimin e datës 07.05.2020 sipas te eilit AK ka marre vendim qe te shpërblejë me kontrate OE "IMK BALLKAN PROJEKT (Lot 2) dhe N.SH IMSS & NNSH GEOKOS A&A (Lot 1) edhe pse te njëjtit me vendimin e datës 24.01.2020, janë cilësuar si me oferta te pa-përgjegjshme dhe me çmime manipulative ne para masë dhe parallogarit ne pozicione te ndryshme. Pra vendimi i fundit i AK bie ndesh me vendimin e datës 24.01.2020. Sipas kësaj del qe oferta jone nuk duhet ti nënshtrohet rregullores per tenderët jo normalisht te ulet pasi qe nuk është plotësuar kushti i krahasimit te 3-ofertave te përgjegjshme (B57 neni 3.1 dhe 3.2) dhe si rezultat i kësaj oferta jone mbetet e vetmja ofertë e përgjegjshme. Është për tu habitur fakti se si OE N.SH IMSS & NNSH GEOKOS A&A shpërblehet me kontratës nga AK edhe pse i njejti formularin e paraqitjes se tenderit nuk e ka plotësuar dhe nënshkruar si duhet. Ky fakt dëshmohet ne

raportet e vlerësimit te përpiluara nga vete AK, ku ne te gjitha raportet e vlerësimit OE N.SH IMBS & NNSH GEOKOS A&A vlerësohet me (JO) ne rubriken tek "formulari i paraqitjes se tenderit i plotësuar dhe nënshkruar si duhet". Ndërsa ne raportin e vlerësimin te dates 07.05.2020 i njëjti OE ne rubrikën "formulari i paraqitjes se tenderit i plotësuar dhe nënshkruar si duhet" vlerësohet me (PO). Pra shihet se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-se (barazia ne trajtim/jo diskriminim) ne raportin e vlerësimit te ofertave. Per sqarim rubrika per te cilen po flasim plotësohet dhe nënshkruhet vetëm ne momentin e dorëzimit te ofertave ne platformën elektronike, çdo plotësim ndryshim i me vonshëm cilësohet si ndërhyrje dhe shkelje e nenin 7 te LPP-se. I njëjti OE nuk ka ofruar dëshmi mbi pronësinë e pajisjeve laboratorike shi është kërkuar ne FDT si rezultat i kësaj] ne kuadër te FDT ka prezantuar nje marrëveshje bashkëpunimi me nje laborator te huaj. Marrëveshja e nënshkruar midis OE IBMS dhe laboratorit IRM nuk është bare ne emër te këtij projekti me validitet te kohëzgjatjes te kësaj] kontrate dhe nuk është bere ne emër te konzorciumit por, është bere vetëm midis ISMS dhe IRM me date *07/06/2018,dhe* e njëjta nuk është e noterizuar siç kërkohet ne dosjen e tenderit.

Neni 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK bere shkelje te nenit 59 te LPP-se sepse ka shpall te përgjegjshëm OE IMK BALKAN PROJEKT SH.P.K edhe pse i njejti nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes se tenderit pika 9.1&9.2.3 "Inxhinier i diplomuar i teknologjisë se materialeve ndërtimore/inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë sepse për këtë pozite emëron z.Sabri Hajdini me diplome inxhinier i teknologjisë (fakulteti i xehetarisë dhe metalurgjisë) dhe po ashtu për laborant emëron z.Burim Binaku qe nuk ka diplome por vetëm certifikata te trajnimeve. I njëjti nuk ka ofruar diplome per shkollimin e kryer por vetem certifikate te trajnimeve, ndërsa ne FDT për pozitën laborant është kërkuar shkolla e mesme - teknik i ndërtimtarisë.

Duke pare shkeljet e dispozitave te Ligjit per Prokurim Publik dhe Rregullores te Udhëzuesit Operativ per Prokurim Publik nga Autoriteti Kontraktues, atëherë kërkojmë nga ju si **OSHP** qe te ktheni përsëri këtë procedure te prokurimit ne procesin e **Rivlerësimit.** Shpresojmë qe ankesa jone te merret parasysh dhe te kemi nje vlerësim sa me te drejte dhe ne si OE te shpallemi si te përgjegjshëm ne te dy lotët.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE **"ETL-KOSOVA"**

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi.
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 60 i LPP-së- Kriteret për dhënien e kontratës
- Neni 61 i LPP-së – Tenderët jo normalisht të ulët
- Neni 69. Aftesia Teknike dhe/ose Profesionale paragrafi 1,2.2,6.3
- Neni 70. Standardet per Sigurimin e Cilësisë
- Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtese

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Arsye te eliminimit sipas AK:

Ne dosjen e tenderit tek pjesa C Formulari i Tenderit nuk është plotësuar si duhet, nuk është evidentuar anëtari i konzorciumit A.L.I.E.A & Geostudio 2000 shpk. Me pas AK thirret ne nje "interpretim" te KRPP-se:

AK citon Shkresën "Kërkesa lidhur me zbatimin e platformës se e-prokurimit" *Nr.112/2016,* te dt: 31.08.2016, dhe Vendimin Nr. *47/2016* te dt: 01.12.2016. Sipas këtyre dy dokumenteve, te gjithë OE te cilët janë te interesuar te marrin pjesë ne aktivitet te prokurimit obligohen qe te regjistrohen ne

platformën elektronike te prokurimit publik. Kjo nënkupton se edhe OE te cilët marrin pjesë si konzorcium, secili anëtar i grupit fillimisht duhet te regjistrohet ne sistem.
NE deklarojmë se kemi vepruar konform Shkresës se KRPP-se *Nr.112/2016,* ku te dy anëtarët e konzorciumit jemi te regjistruar ne platformën e prokurimit publik e-prokurimi, si dhe konforrn Vendimit te KRPP-se për *Nr.47/2016* per tu regjistruar ne platformën e prokurimit publik si dhe për ta dorëzuar tenderin vetëm ne mënyrë elektronike. Ne shkresën dhe Vendimin. te cilave i'u referohet AK, askund nuk ceket ne mënyrë decidivc sc ne nje rast tc tille OE duhet te eliminohet si i papërgjegjshëm. Ne mendojmë se nje gje e rille do te ishte e drejte qe te ishte ne diskrecion te AK-se dhe te konsiderohej si *Dev~jil1i Vogel,* duke patur parasysh rëndësinë e aktivitetit te prokurimit dhe ruajtjen e buxhetit, pasi qe oferta jone është oferta me serioze , si për nga ana ekonomike ashtu edhe nga ajo teknike. Gjithashtu mendojmë se është ne diskrecion te AK-se qe ofertën tone ta konsideroj te përgjegjshëm, duke iu referuar vetëm dokumentacionit te dorëzuar nga anëtarë i konzorciumit ETL-Kosova, dhe mbi këtë baze edhe te behet evaluimi i ofertës. Pasi qe oferta jone eshte mjaft serioze dhe me kete do te kursehej dukshëm buxheti.
Gjithashtu AK, për te disatën here nuk e beri drejte evoluimin dhe vlerësimin e tenderëve, duke mos i bere transparente çmimet e ofruara nga OE. Pra nuk dihet se cilat janë çmimet njësi dhe çmimet njesi te peshuara. Këtë e ka theksuar edhe ekspertiza e OSHP-se 459/19 dhe 460/19 e datës 29.08.2019,duke e konsideruar si lëshim teknik, mirëpo edhe përkundër kësaj asnjëherë AK nuk e përmirëson atë gabim" teknik, dhe kështu duke mos qene transparent.

Vërejtjet për OE fitues, Lot 1. IMK BALLKAN PROJEKT
OE i mungon Certifikata e Numrit Fiskal OE IMK BALLKAN PROJEKT, te paktën 17 prova nga Lista e provave te kërkuara nga AK ne Dosjen e Tenderit, nuk i ka te akredituara, gje qe me automatizëm Operatorin ekonomik Ballkan Projekt do ta nxirrte si te papërgjegjshëm,
Disa nga provat për te cilat OE nuk është i akredituar:
2.11. Përshkueshmëria (Permeability)
2.12. Ekuivalenti i reres EN-933-8
2.15. Ekzaminimi i rezistences ndaj goditjes te agregatit kokerrmadh (Impact test)
2.16. Analiza kimike e agregateve EN-932-3
2.17. Analiza mineralogjiko-petrografike
3.3. Përcaktimi i poreve te mbyllura ne betonin e freskët me porozimeter EN-12350-7
3.7. Ekzaminimi i rezistencës ne përkulje i mostrave te betonit (mostra prizmatike)
3.8. Ekzaminimi i rezistencës ne tërheqje i mostrave te betonit EN 12390-6
3.19. Ekzaminimi i gypave te betonit
3.2. Ekzaminimi i betonit me metodën destruktive (nxjerrje e mostrave cilindrike)
3.21. Ekzaminimi i betonit me metodën destruktive (Përgatitja e mostrave cilindr.)
3.23. Ekzaminimi i betonit me metodën destruktive (Ekz. Ne shtypje mostrave cilin.)
3.25. Ekzaminimi i betonit me metodën jodestruktine (Ultraconic)
6.2. Përmbajtja e bitumit ne përzierjen e asfaltit
7.7. Analiza granulometrike pas ekstrahimit EN 12697-2
7.9. Permb. e bitumit ne perzierje asfaltike pas ekstrahimit EN 1269718, ASTM 02172
5.3. Duktiliteti EN 13398
Deklarata e Menaxherit te projektit nuk përmban as date e as titull te projektit per te cilin është emëruar si projekt menaxher. Pra nuk pasqyron saktë qëllimin e deklaratës. Inxhinieri i caktuar per Lot.1 z.Kadri Morina, nuk e ka te nënshkruar CV-ne. z.Burim Binaku i caktuar si laborant per Lot. 1 ka shkollën e

mesme teknik i xehetarisë. Ne vend te inxhinierit te teknologjisë se materialeve ndërtimore/inxhinier i ndërtimtarisë, kompania emëron a.Sabri Hajdini qe është inxhinier i teknologjisë, pra jo adekuat. Pastaj z.Zeqir Leci është me shkolle te mesme te ndërtimtarisë, Nysret Bekteshi shkolla e mesme e ndërtimtarisë. Pra vetëm sa i përket stafit OE Ballkan Projekt ka mungesa te theksuara substanciale. Gjithashtu OE ka mungesa te theksuara sa i përket pajisjeve laboratorike, si psh: Pajisja Ultrasinic, paisja per analizat mineralogjike-petrografike, duktilitetit, etj. Te gjitha këto vërejtje tona janë te konfirmuara nca aSHP ne Vendimin e tyre Nr: 459119 dhe 460119, te datës 11.09.2019

Vërejtjet për OE fitues, Lot.2 NSH."IBMS ;N.N.5h.,Geokos A & A

OE NSH.IIIBMS i mungon Aneksi i Akreditimit, e cila është pjese e pandashme e Certifikatës se Akreditimit, ku mund te shihen se per cilat prova është i akredituar. Gjithashtu OE N.N.Sh.,Geokos A & A, i mungon Aneksi i Akreditimit, ku mund te shihen se per cilat prova laboratorike është i akredituar. Megjithatë nga Aneksi i provave te akredituara, i cili eshte dokument publik ne faqen e Drejtorisë se Akreditimit, shihet qarte se ky konzorcium i ka te paktën 40 prova te pa akredituara, sipas listen qe eshte kerkuar nga AK (rreth 50% te provave te pa akredituara). Mungesa e kaq provave, automatikisht do duhej te nënkuptonte se konzorciumi ne fjale është i papërgjegjshëm. Mirëpo pas kësaj ne e verne ne pikëpyetje profesionalizmin e komisionit vlerësues, pasi qe asnjëherë nuk i ka shqyrtuar keto mungesa, qe ne fakt janë thelbi i ofertës.

Disa nga provat per te cilat OE nuk eshte i akredituar:

1.5. Përcaktimi i masës specifike me piknometër
1.6. Caktimi i prezencës se materieve organike ne materialin mbushës
1.9. Proetori standard ose i modifikuar
1.10.. CBR laboratorike (3 pika)
1.11. Përcaktimi i densitetit ne terren
1.14. Përcaktimi i modulit dinamik, prova me pllake me renie.
2.7. Forma e kokrrave te agregatit EN 933-4
2.8. Caktimi i thithshmërisë se ujit EN 1097-6
2.11. Përshkueshmëria (Permeability)
2.12. Ekuivalenti i reres EN-933-8
2.15. Ekzaminimi i rezistencës ndaj goditjes te agregatit kokërrmadh (Impact test)
2.16. Analiza kimike e agregateve EN-932-3
2.17. Analiza mineralogjike-petrografike
3.3. Përcaktimi i poreve te mbyllura ne betonin e fresket me porozi metër EN-12350-7
3.5. Matje e masës vëllimore te mostrave te betonit te ngurtësuar EN 12390-7
3.8. Ekzaminimi i rezistencës ne tërheqje EN 12390-6
3.9. Caktimi i depërtimit te ujit me shtypje ne beton
3.10. Caktimi i dimenssionit te gureve anesore
3.11. deri 3.23. nuk i ka te akredituar
3.25. Ekzaminimi me metoden jodestruktive (Ultrasonic)
6.3. Analiza granulometrike pas ekstrahimit
6.6. Përcaktimi i zbrazëtirave ne perzierjen bituminoze EN 12697-8
5.3. Duktiliteti EN 13398

OE NSH.IBMS nuk ka ofruar dëshmi mbi pronësinë e pajisjeve laboratorike siç është kërkuar ne FDT. Por ka ofruar nje marrëveshje me nje operator slloven, mirëpo kjo marrëveshje nuk është e specifikuar se është per projektin ne fjale, ashtu sic kërkohet ne FDT, si dhe kjo marrëveshje nuk është e noterizuar. Gjithashtu OE N.N.Sh.,Geokos A & A, nuk ka ofruar dëshmi mbi pronësinë e pajisjeve

laboratorike sic është kërkuar ne FOT. Menaxheri i Projektit Lot.2. z.Cene Krasniqi, e ka te panënshkruar CV-ne, e gjithashtu i mungojnë referencat e lëshuara nga punëdhënësi Laboranti Fehat Kastrati, e ka te panënshkruar CV-ne. Te gjitha këto vërejtje tona janë te konfirmuara nga OSHP ne Vendimin e tyre Nr: 459/19 dhe 460119. te datës 11.09.2019

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

OE"IPE CONTROLS"është ofertues i pasuksesshëm.OE fitues nuk i ka plotësuar kërkesat 9.1&9.2te FDT
OE "IPE PROING" është eliminuar për shkak se nuk ka arsyetuar me dëshmi çmimet jo/normalisht te ulte
OE"ETL-KOSOVA" eshte eliminuar per shkak se anëtari i konzorciumit nuk është evidentuar ne formularin e tenderit përmes regjistrimit ne Platformën elektronike.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Raporti i komisionit vlerësues i konstaton këto te gjetura.
OE"IPE CONTROLS"është ofertues i pasuksesshëm.OE fitues nuk i ka plotësuar kërkesat 9.1&9.2te FDT
OE "IPE PROING" është eliminuar për shkak se nuk ka arsyetuar me dëshmi çmimet jo/normalisht te ulte
OE"ETL-KOSOVA" eshte eliminuar per shkak se anëtari i konzorciumit nuk është evidentuar ne formularin e tenderit përmes regjistrimit ne Platformën elektronike.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).
Operatoret Ekonomik ankues **nuk janë** pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
Ka pasur tri vendime te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit Nr. 459-460/19, Nr. 815-818-825-832/19 dhe Nr.84-101/20

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshëm).
Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "IPE-CONTROLS", OE "IPE PROING dhe "ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000 "

OE "IPE-CONTROLS"

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor të OE "IPE-CONTROLS" se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 2 nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit 9.1& 9.2 që lidhet me stafin e kërkuar inxhinjeret dhe tekniket e ndertimtarise, eksperti shqyrtues ka dhene mendim per kete çeshtje ne raportin e me hershem i cili eshte perfshire edhe ne vendimin e OSHP nr.459/19, 460/19. Ky pretendim është i perseritur. Kjo eshte çeshtje e trajtuar dhe gjykuar me vendimin nr. 459-460/19 nga paneli shqyrtues "res judicata" sipas nenit 105 të LPP-së pika 2.16. Pretendimi është i **bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Sa i përket pretendimit tjetër të OE "IPE CONTROLS" se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat financiare të pikës 8.1&8.2 të dosjes së teënderit ku janë kërkuar Deklaratat tatimore vjetore të ATK-së sepse këto deklarata nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga ATK, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE i rekomanduar për kontratë për LOT 2 me ofertë ka dorzuar Deklaratat tatimore për tri vitet e fundit sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Deklaratat në fjlaë janë me logo origjinale të ATK-së. Në kërkesën e dosjes së tendeit nuk është kërkuar që këto deklarata të janë të nënshkruara dhe vulosura. Prandaj në mënyrën si janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe njëoftimit për kontratë, ato janë ofruar nga OE i rekoamduar për kontratë për këtë Lot. Eksperti shqyrtues nuk ka vërejtë asnjë elemnet të dyshimt në këto deklarata. Si i tillë ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmimin e njëjtë si me pa TVSH si me TVSH dhe dyshojm se ka manipulime të çmimeve, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në listën e çmimeve të OE fitues për Lot 2 e cila është dorzuar me ofertë në platformën elektronike shihet se çmimet janë të dhënë për njësi në secilin pozicion duke përfshirë edhe çmimet e peshuara.
Në tabelën përfundimtare në rekapitullim, shumë çartë shkruan "çmimi për njësi me TVSH i peshuar". Pra nga kjo shihet se për secilin pocion ku është shkruar çmimi është i përfshirë edhe TVSH-ja. Pra çmimet janë dhënë me TVSH brenda. Kjo është në rregullë. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

OE "IPE PROING"

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor se AK na ka eleminuar pa të drejtë me arsyetimin se ne nuk jemi përgjigjur në kërkesën për sqarim për çmime jo normalishtë të ulëta. Problemet që lidhuen me user të kompanisë tonë platformën elektronike, eksperti shqyrues ka këtë mendim.

Ky aktivitet i prokurimit është tejzgjatur dhe janë nxjerr disa raporte të ekspertit shqyrtues dhe vendime të OSHP-së ku është trajtuar çështja e çmimeve jo/normalisht të uëlëta. Eksperti shqyrtues ka dhënë mendim në raportin e më hershëm për çmimet e ofertës së OE ankues në këtë rast që është përshkruar edhe në vendimin e OSHP-së nr.459, 460/19. Mirëpo, pavarsishtë kësaj, sipas vendimt nr.84-101/20 të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit lënda është ktyher në rivlerësim. Procesi i rivlerësimit nënkupton që i tërë aktivitetit

duhet të vlerësohet nga një komision i ri i vlerësimit të ofertave. Komisioni i ri i vlerësimit ka të drjeta të plotë për gjithë procesin e vlerësimit duke përfshirë edhe kërkesat për sqarime të çmimeve që ju drejtohen OE, si në rastin konkret. Pretendimi i OE ankues se çështja e userit për kompaninë e tyre të regjistruar në platformën elektronike ka ndikuar në mospërgjigjen në kërkesën e AK për sqarime të çmimeve jo/normalisht të uëlta, për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk është arsyetim. AK ka vepruar njëjtë edhe me operatorët e tjerë ekonomik. Vetëm OE ankues në fjalë nuk i ka kthyer përgjigjigjeje AK në pyetjen për çmimet jo/normalisht të ulëta.
Për këtëo rast "Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët (B57)" neni 4.3 thotë:
"Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet".

Mbi këtë bazë autoriteti kontraktues e ka refuzuar ofertën e OE ankues"IPE PROING" sepse nuk ka marrë përgjigjeje në pyetjen për sqarime shtesë që lidhet me çmimet jo/normalisht të ulëta. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.2
Sa i përket pretendimit tjetër ankimor se AK ka marrë vendim me datë 07.05.2020 ti shpërblej me kontratë dy OE, njërin për Lot 1 dhe tjetrin për Lot 2 edhe pse të nëjtit operator me vendimin e datës 24.01.2020 të AK-së janë cilësuar si tenderues të pa përgjegjshëm dhe me çmime manipulative. Pra vendimi i fundit i AK-së bie ndesh me vendimin e datës 24.01.2020, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Arsyeja pse dy vendimet e AK për shpërblim me kontratë të operatorëve ekonomik, janë ndesh njëri me tjetrin është për shkak se për vendimin e AK-së të datës 24.01.2020 ka pasur dy ankesa në OSHP pikërisht nga dy operatorët ekonomik që tani janë shpërblyer me kontratë dhe me vendimin nr.84-101/20 të OSHP-së lënda është kthyer në rivlerësim. Për këtë arsye dy vendimet e AK-së bien ndesh njëri me tjetrin, si rezultat i vendimit të OSHP-së. Këto raste janë të rëndomta në procedurën e prokurimit dhe parashihen edhe me ligj të prokurimit. Ndyshimi i vendimit të AK-së është bërë me qëllim të zbatimit të vendimit të OSHP-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i **pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.3
Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit pika 9.1&9.2 që ka të bëjë me stafin e kompanisë, lidhur me inxhinjerët dhe laborantët, eksperti shqyrtues ka dhënë mendim për këtë çështje në raportet e më hershme, pra ky është pretendim i përseritur i cili është gjykuar nga paneli shqyrtues "res judicata" sipas nenit 105 të LPP-së pika 2.16. Pretendimi është i **bazuar.**

"ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000"

Përgjigje në Pretendimin nr.1
Lidhur me pretendimin e OE ankues "ETL-KOSOVA" se oferta e tyre është eleminuar pa të drejtë me arsyetimin se formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet, nuk është evidentuar anëtari i konzorciumit "A.L.T.E.A & Geostudio 2000" ne sistemin elektronik, ne deklarojm që të dy anëtarët e konzorciumit jemi të regjistruar në sistemin elektronik.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues ka dhënë mendim në raportin e datës 06.12.2019 dhe është konfirmuar edhe me vendimin e OSHP-së nr.815-825-818-832/19. Pra ky pretendim eshte i përseritur i cili është gjykuar nga paneli shqyrtues "res judicata" sipas nenit 105 të LPP-së pika 2.16. OE ankues për këtë çështje është i **pa përgjegjshëm.** Pretendimi është i **pa bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 1. "IMK Balkan Projekt" të paktën 17 prova nga lista e provave të kërkuara në DT nuk i ka të akredituara, deklarata e menaxherit nuk përmbanë as datë as titull të projektit për të cilin është emruar, inxhinjerët e caktuar për Lot 1 Kadri Morina nuk e ka të nënshkruar CV-në, po ashtu z. Burim binaku i caktuar si laborant për Lot 1 ka shkollën e mesme të xehtarisë etj, Eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ky pretendim eshte gabimisht i paraqitur nga OE ankues sepse fitues per Lot 1 nuk është OE"IMK Balkan Projekt" por fitues ne kete lote eshte "IBMS & Geokos A&A". Prandaj nuk mundet te shqyrtohet ky pretendim ankimor.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Sa i përket pretendimit të fundit ankimor të OE ankues për Lot 2 se OE i rekomanduar për kontratë "IBMS & Geokos A&A" i mungon ankesi i akreditimit e cila është pjesë e çertifikatës së akreditimi, ku mundet të shihet se për cilat prova është i akredituar. Ky konzorcium ka të paktën 40 prova të pa akredituara, këtij OE i mungojnë paisjet laboratorike siç është kërkuar në FDT, marrveshja e ofruar me një operator slloven për pajisje nuk është e noterizuar, çështja e menaxherit që e ka CV të pa nënshkruar etj, eksperti shqyrtues ka kete mendim.

Edhe ky pretendim i OE ankues ne fjale është gabimisht i paraqitur sepse per Lot 2 dy nuk eshte fitues OE "IBMS & Geokos A&A" por fitues ne kete lot eshte OE "IMK Balkan Projekt". Prandaj nuk mundemi te shqyrtojm as këtë pretendim ankimor.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ky aktiviteti i prokurimit është tejzgjatur dhe janë nxjerr tri vendime të OSHP-së, tani është në ankesë për të katërten herë. Është i çuditshëm fakti se të tre operatorët ekonomik ankues ankues aktual janë shpallur të **pa përgjegjshëm** me vendimin e AK-së të datës 24.01.2020 dhe asnjëri nga këta tre operatorë ekonomik nuk ka paraqitur ankesë në OSHP. Që do të thotë janë pajtuar me vendimin e AK të datës 24.01.2020 për eleminimin e ofertave të tyre. Pra në këtë rast nuk kanë qenë palë me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-së. Me vendimin e AK të datës 24.01.2020 nuk ishin pajtuar dy OE aktual të rekomanduar për kontratë dhe të njëjtit kishin paraqitë ankesë në OSHP. Këto dy ankesa ishin aprovuar me vendimin e panelit shqyrtues nr.84-101/20 dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim. Pas rivlerësimit të ofertave, AK merr vendimin e datës 07.05.2020 dhe rekoamdon për kontratë dy operatorë ekonomik. Tani përsëri paraqesin ankesë të tre OE ankues aktual. Kjo gjendje e ka komplikuar mjaftë situatën. Gajte rivlerësimit nuk janë respektuar ne tërësi dispozitat e nenit 59 të LPP-së. Bazuar në sqarimet e dhëna më lartë, eksperti shqyrtues, megjithëatë i vlerëson **pjesërisht të bazuar** ankesat e OE **"IPE-CONTROLS-ING"** dhe OE **"IPE PROING"** ndërsa **refuzohet** si e **pa bazuar** ankesa e OE **"ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000"**.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që aktivitetin e prokurimit **"Ekzaminimet kontrolluese për materiale dhe kualitetin e punëve, ne projektet e infrastrukturës rrugore" Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prok.205/19/1724/211** ta kthej në **Rivlerësim** dhe të veproj në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Ministria e Infrastrukturës
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - OE"IPE-CONTROLS"
  - OE "IPE PROING dhe
  - OE "ETL-KOSOVA & A.L.T.E.A & Geostudio 2000"